

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 580 Prot.


Tiranë, më 03.06 2016

VENDIM Nr. 40, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të shkollës doktoale "Metodologjitë dhe praktikat e kërkimeve në fushën e prehistorisë"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Ilir Gjipali (IA), Prof. Adem Bunguri (IA),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të shkollës doktoale "Metodologjitë dhe praktikat e kërkimeve në fushën e prehistorisë"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Ilir Gjipali (IA), Prof. Adem Bunguri (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kërkimet e vëzhgimit arkeologjik (survey) për prehistorinë do të kryhen në zonën perëndimore të bregliqenit të Pogradecit, ndërsa sondazhet do të bëhen në vendbanimet e neolitit të hershëm pranë ish Shtëpisë së Pushimit brenda qytetit të Pogradecit si dhe në bregun e Lin 3, ku janë gjetur gjurmë të një vendbanimi prehistorik, në vazhdim të atij nënujor palafit.
 - Kërkime nënujore do të realizohen në zonën e Linit për përcaktimin e planimetrisë së shtrirjes së sitit të emërtuar Lin 3. Ato do të shoqërohen me përgatitjen e një masterplani afatgjatë për të në përputhje me rekomandimet e UNESCO-s. Në Prespë 1, kërkimet nënujore do të kenë si objektiv përcaktimin e planimetrisë së sitit të zbuluar në vitin e kaluar.
2. Nuk miratohet germim sondazh (kontrolli) në vendbanimin prehistorik të Maliqit, Korçë, për të mundësuar marrjen e kampionëve për analiza dhe për të inkuadruar ato me kërkimet e mëparëshme të kryera në Maliq, pasi paraprakisht duhet të krijohet harta e kërkimeve të mëparëshme.
3. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë Maj-Qershor dhe Shtator 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

4. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO